



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

LICENCË PËR BASHKËPRODHIM TË ENERGISË ELEKTRIKE DHE TERMIKE

DHËNË :

KORPORATËS ENERGETIKE TË KOSOVËS SH.A

Divizioni i Gjenerimit, TC “Kosova B”

Numri i Regjistrimit: ZRRE/Libp_05/12_B



PËRMBAJTJA

KREU I: TERMAT E LICENCËS.....	3
KREU II: KUSHTET E LICENCËS	5
Neni 1: Përkufizimet.....	5
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit	6
Neni 3: Ndalimi i Ndër-subvencioneve	7
Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit	7
Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji	7
Neni 6: Sigurimi i rezervave të lëndëve djegëse	7
Neni 7: Dispeçingu Qendror	8
Neni 8: Shërbimet Ndhmëse	8
Neni 9: Caktimi i Operatorit	9
Neni 10: Rregullat e Tregut	9
Neni 11: Shëndeti dhe Siguria	9
Neni 12: Mjedisi	9
Neni 13: Puna	10
Neni 14: Tjetërsimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit.....	10
Neni 15: Obligimi i Sigurimit.....	10
Neni 16: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit	10
Neni 17: Obligimet e Shërbimit Publik	11
Neni 18: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së	11
Neni 19: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....	12
Neni 20: Taksat	12
Neni 21: Masat Administrative dhe Gjobat	12
Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve.....	12



KREU I: TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje "ZRRE")**, në pajtim me autoritetin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185), Nenit 15 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L- 184), Nenin 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L – 201) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, i modifikon Korporatës Energjetike të Kosovës("KEK") SH.A.- Divizionit të Gjenerimit (tani e tutje "i Licencuari") licencën për gjenerim të energjisë elektrike në licencë për bashkëprodhim të energjisë elektrike dhe termike, në centralin gjenerues Kosova B.
2. Kapaciteti nominal (i instaluar) i përgjithshëm prodhues i njësive të bashkëprodhimit të TC Kosova B është: B1- 339 MW, B2- 339 MW;
3. Kapaciteti aktual në disponim i përgjithshëm i prodhimit të njësive të bashkëprodhimit të TC Kosova B është: B1 - 264 MW, B2- 264 MW, e i cili mund të ndryshojë. Ky kapacitet përdoret për prodhimin e energjisë elektrike dhe energjisë termike sipas Marrëveshjes për furnizim me energji termike të lidhur mes KEK dhe NQ Termokos.
4. Kapaciteti nominal (i instaluar) i prodhimit të energjisë termike nga TC Kosova B është: Njësia B1- 70 MW_{TH}; Njësia B2- 70 MW_{TH}
5. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
6. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me Nenet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Energji Elektrike, Ligjin për Ngrohje Qendrore dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
7. Nga i Licencuari kërkohet që t'i ofrojë furnizuesit publik energjinë elektrike me çmim të rregulluar të prodhuar nga centralet e veta të bashkëprodhimit të energjisë elektrike dhe termike , në përputhje me Nenin 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
8. Pas plotësimit të obligimeve të furnizuesit publik të përcaktuar me këtë Licencë, i Licencuari mund ta shes energjinë elektrike që e prodhon nga centrali i tij i bashkëprodhimit të energjisë elektrike dhe termike me çmime të negociuara si në vijim:
 - 7.1. konsumatorëve të kualifikuar, nëse Prodhuesi ka licencën për Furnizim me shumicë (import dhe eksport) të energjisë, të lëshuar nga ZRRE;
 - 7.2. konsumatorëve jashtë territorit të Republikës së Kosovës;
 - 7.3. tregut të brendshëm apo rajonal të shkëmbimit të energjisë elektrike; dhe
 - 7.4. furnizuesve tjerë.



9. I Licencuari do të shes energjinë termike të prodhuar në centralin e tij me çmim dhe sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen për furnizim me energji termike, në përputhje me marrëveshjet dhe vendimet përkatëse, si dhe me legjislacionin në fuqi.
10. Në përputhje me kërkesat e Legjislacionit në fuqi dhe kësaj licence, i Licencuari do të menaxhojë në mënyrë ekonomike centralin e bashkëprodhimit të energjisë elektrike dhe termike, si në vijim:
 - 10.1. të përdorë në centralet e tij ato burime kryesore të energjisë që i konsideron si më të përshtatshme duke pasur parasysh dizajnin e njësive, me kusht që të jetë në pajtim me karakteristikat teknike, dhe kushtet mjedisore që përfshihen në licencë dhe në legjislacionin në fuqi;
 - 10.2. të kyçë centralin e tij në Sistemin e Transmisionit ose Shpërndarjes të energjisë elektrike sipas kushteve të përcaktuara në kodet dhe rregullat përkatëse;
 - 10.3. të transmetojë (bartë) energjinë elektrike përmes Sistemit të Transmisionit dhe Shpërndarjes;
 - 10.4. të kyç centralin e tij gjegjësisht pajisjet e ekstraktimit të avullit me stacionin e ekstraktimit të energjisë termike dhe mëtutje me rrjetin e transportimit të energjisë termike;
 - 10.5. të transportoj energjinë termike përmes rrjetit të transportimit të energjisë termike;
 - 10.6. të realizoj pagesën e duhur sipas kontratave.
11. Licenca vlen nga data **04 Tetor 2006** dhe, do të vazhdojë të jetë e vlefshme gjatë kohëzgjatjes teknike të pjesëve kryesore të centralit ekzistues që përdoren për kryerjen e aktiviteteve relevante deri më **04 Tetor 2026**.
12. Në rast të ndryshimit në kapacitetin e njësive të bashkëprodhimit të Kosovës "B" i Licencuari menjëherë do të njoftojë ZRRE-në.
13. Në pajtim me Nenin 34 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë modifikon licencën për gjenerim të energjisë elektrike me numër ZRRE_Li_05/06_B e lëshuar me datë 04 tetor 2006 dhe e modifikuar me datë 18.07.2012, nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe hynë në fuqi me datë **23.12.2014**.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji: _____

Nënshkruar: (në emër të Bordit të ZRRE-së)



KREU II: KUSHTET E LICENCËS

Neni 1: Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:

"Anëtar" - marrëdhënia e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës i ndonjë ndërmarrje Aksionare të të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.

"Shërbime Ndhmëse" të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes.

"Vit financiar" - periudha prej 1 Janar deri me 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

"Njësi bashkëprodhimi (kogjenerimi)" - çdo central apo pajisje për bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe termike.

"Kompani aksionare" - një kompani e definuar si e tillë, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

"Legjislacion" – Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 03/L - 184), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L - 185), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L - 201), Ligji për Ngrohjen Qendrore, si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.

"Rregulla të Tregut" - rregulla të miratuara nga ZRRE që përcaktojnë funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe raportet në mes të Operatorit të Tregut dhe pjesëmarrësve në treg, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

"Kode" - rregullat teknike të përpiluara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të aprovuara nga ZRRE-ja, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

"Marrëveshje për Blerje të Energjisë" – marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike me prodhuesin e energjisë në pajtim në Nenin 18 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Vartës" - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

2. Termet e përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.



Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit

1. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Financiare vjetore në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara, brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Llogaritë e brendshme duhet të jenë të ndara për aktivitetet e Prodhimit nga llogaritë e brendshme për aktivitetet e tjera, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndonjë ndërmarrje tjetër.
2. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditor i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
3. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin Prodhues në tërësi, si dhe për aktivitetet tjera. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, dhe ndër të tjerash mund të specifikojë:
 - 3.1 formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, aseteve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve prodhuese të konsoliduar dhe ndonjë aktiviteti tjetër;
 - 3.2 natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, aseteve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;
 - 3.3 parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, I Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe legjislacioni në fuqi.



Neni 3: Ndalimi i Ndër-subvencioneve

I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që aktiviteti prodhues të japë apo të marrë ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtarit dhe/ose nga ndonjë person tjetër.

Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit

1. I Licencuari në ç'do kohë do t'i raportoj ZRRE-së lidhur me rrethanat e shitjes ndaj blerësve, përfshirë (pa kufizim) vëllimin, faktorët e ngarkesës, kushtet e ndërprerjes, afatet dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve përkatëse.
2. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE informacione rreth:
 - 2.1. sigurimit të energjisë elektrike për çdo furnizues publik;
 - 2.2. sigurimit të energjisë elektrike për çdo konsumator tjetër;dhe
 - 2.3. sigurimit të energjisë termike për NQ Termokos si Furnizues Publik me ngrohje, sipas marrëveshjes së furnizimit me energji termike.
3. Sigurimi i energjisë elektrike për çdo konsumator gjithashtu do të përfshijë sigurimin e kapacitetit në dispozicion të çdo njësie gjenerimi.

Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

1. I Licencuari do të veprojë në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit Elektrik, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e atyre dispozitave që nuk është e mundur të zbatohen sipas paragrafit 1 të këtij Neni. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 6: Sigurimi i rezervave të lëndëve djegëse

1. I licencuari do të përgatisë planin për rezervat e lëndëve djegëse, sipas Nenit 10 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike si dhe me legjislacionin sekondar, lëshuar nga Ministria përkatëse.
2. I licencuari do të veprojë në përputhje me çdo dispozitë që përcakton llojin dhe masën e minimumit të rezervës së lëndëve djegëse, si dhe legjislacionin sekondar të Ministrisë përkatëse dhe Kodet në fuqi.



Neni 7: Dispeçingu Qendror

1. I Licencuari do të paraqesë të gjitha njësitë e gjenerimit në dispozicion në Dispeçingun Qendror nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, kur Dispeçingu Qendror kërkohet sipas Kodit të Rrjetit Elektrik dhe Rregullave të Tregut.
2. I Licencuari, do t'i sigurojë Operatorit të Sistemit të Transmisionit, të gjitha informacionet e kërkuara, në mënyrë që ta aftësojë për të vënë në funksion sistemin e Dispeçingut Qendror, sa herë dhe në mënyrën siç parashihet me Kodin e Rrjetit Elektrik.

Në këtë Nen:

"Në dispozicion" - në lidhje me çdo njësi gjenerimi nënkupton njësinë e gjenerimit që është në dispozicion në përputhje me Kodin e Rrjetit Elektrik, dhe

"Dispeçingu Qendror" - procesin e planifikimit dhe lëshimit të udhëzimeve direkte për dispeçimin e njësive të gjenerimit në dispozicion prej Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

Neni 8: Shërbimet Ndhmëse

1. I Licencuari do të ofrojë kushte për furnizim të Shërbimeve Ndhmëse prej çdo njësie gjenerimi, në rast se kjo kërkohet prej Operatorit të Sistemit të Transmisionit, në përputhje me Kodin e Rrjetit Elektrik.
2. Kur kushtet e ofruara nga i Licencuari janë të pranueshme për Operatorin e Sistemit të Transmisionit, atëherë ata mund të lidhin marrëveshje.
3. Nëse Operatori i Sistemit të Transmisionit konteston kushtet e ofruara nga i Licencuari sipas paragrafit 1 të këtij neni, ZRRE-ja do të përcaktojë çdo kusht të marrëveshjes që është në mospërputhje sipas Rregullës për Procedurën e Zgjidhjes së Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
4. Nëse Operatori i Sistemit të Transmisionit procedon në bazë të kushteve të përcaktuara nga ZRRE-ja, i Licencuari do të bëjë marrëveshje për shërbime ndihmëse dhe do ta zbatojë atë në përputhje me kushtet e saj.
5. I Licencuari, sipas paragrafit 1 të këtij neni, pas kërkesës së ZRRE-së, do ti dorëzoj ZRRE-së raportin me detajet si në vijim:
 - 5.1. çmimet e ofruara për sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse nga çdo njësi të bashkëprodhimit të të Licencuarit; dhe
 - 5.2. detajet lidhur me koston e të Licencuarit për sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse.



Neni 9: Caktimi i Operatorit

1. I Licencuari do të emëroj një person të kualifikuar dhe me përvojë përkatëse që të jetë përgjegjës për operimin e çdo njësie të bashkëprodhimit të përfshirë në licencë. Para emërimit të ndonjë personi të tillë i Licencuari duhet të siguroj pëlqimin me shkrim nga ZRRE-ja.
2. Nëse personi nuk është kompetent që të ushtroj atë funksion, ZRRE-ja me njoftim me shkrim dhënë të licencuarit, mundet ta kërkoj zëvendësimin e atij personi.
3. ZRRE-ja sipas paragrafit 2 të këtij Neni do të përcaktojë se cilat kritere do të merren parasysh në shqyrtimin e kompetencës, në përputhje me kriteret që lidhen me njohuritë dhe aftësitë profesionale, përvojën, si dhe me kriteret që lidhen me kërkesën për mbrojtje dhe sigurim të prodhimit.

Neni 10: Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të veproj në pajtim me Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e disa dispozitave të Rregullave të Tregut. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 11: Shëndeti dhe Siguria

1. I Licencuari duhet t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për t'i mbrojtur personat nga lëndimet dhe dëmtimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë ushtrimit të aktivitetit të Prodhimit, në përputhje me Legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontroll teknik dhe të sigurisë së kapaciteteve të Gjenerimit në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do t'i dërgojë në ZRRE, sa herë që kjo kërkohet nga ZRRE-ja.

Neni 12: Mjedisi

1. I Licencuari do t'i dërgoi ZRRE-së kopje të lejes Ekologjike për mbrojtjen e mjedisit dhe dokumentet tjera të lëshuar nga Ministria përkatëse për mjedis. I Licencuari duhet të veprojë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisin në Kosovë.
2. I Licencuari do t'i raportojë ZRRE-së për çdo vit mbi aktivitetin e tij mjedisor



Neni 13: Puna

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 14: Tjetërsimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit

1. I Licencuari nuk do të shes apo heq dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikoj në aftësinë për ti kryer obligimet e tij apo nëse aseti ka vlerën e zëvendësimit mbi njëqindmijë Euro (100,000.00 €).
2. Në rastet kur i Licencuari dëshiron të tjetërsojë asetet apo pasuritë tjera që përdoren në ushtrimin aktivitetit të licencuar, i Licencuari është i detyruar të njoftojë me shkrim ZRRE-në. I Licencuari mund të bëjë tjetërsimin e ndonjë aseti pas aprovimit me shkrim nga ZRRE.

Në këtë Nen:

“Tjetërsimi” - çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një Biznesi tjetër të të Licencuarit ose pale të tretë.

“Aset Relevant” - konsiderohet të jetë çdo pronë apo pajisje që përdoret nga i Licencuari në ushtrimin e aktiviteteve të dhëna me këtë Licencë, përfshirë çdo interes ligjor apo të dobishëm për ndonjë tokë apo objekt, dhe çdo pronësi intelektuale.

Neni 15: Obligimi i Sigurimit

1. I licencuari do të bëjë sigurimin e asetëve në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2. I licencuari do të lidhë kontrata për sigurimin e asetëve të gjenerimit dhe për pajisjet që përdoren për prodhim të energjisë elektrike. Kontrata e tillë do t'i dërgohet ZRRE për rishikim në baza vjetore.

Neni 16: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.



Neni 17: Obligimet e Shërbimit Publik

I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik që mund t'i vendoset nga ZRRE-ja, në përputhje me Nenin 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 18: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do t'i dorëzojë ZRRE-së informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. I Licencuari do ti dërgoj ZRRE-së raportet tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë prodhuese dhe pajtueshmërinë me Nenet dhe kushtet e licencës sipas Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE-ja.
3. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullin për Informatat Konfidenciale, kërkon që ndonjë informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial, atëherë është i obligim i tij që të shënoj atë informacion si konfidencial dhe të arsyetoj kërkesën e tij te ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. Zyra e Rregullatorit për Energji ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
5. I Licencuari do të emërojë një person përmes të cilit do të ketë lidhje komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut. Adresa, numri i telefonit, faksit ose adresa elektronike e personit të tillë do t'i dërgohen Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut.
6. I Licencuari, sa herë që kërkohet, do ti dërgojë ZRRE-së çdo kopje të kontratave të nënshkruara në lidhje me tregtinë ndër- kufitare me energji elektrike, kontratat për furnizim, marrëveshjet për blerje të energjisë elektrike dhe çdo kontratë të nënshkruar në pajtim me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë Elektrike.
7. I Licencuari duhet t'i dërgojë ZRRE-së detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguara gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

"Informacioni" - materiali që në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE.



Neni 19: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 20: Taksat

I Licencuari do t'i paguajë ZRRE-së çdo taksë fillestare dhe vjetore të caktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

Neni 21: Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE apo Nenet dhe kushtet e kësaj Licence apo instruksionet e dhëna të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendos të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 52 të Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.